



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istog
Municipality of Istog

01 Nr. 415/ 2025
28.05.2025

KRYETARI / PREDSEDNIK / MAYOR

<https://kk.rks-gov.net/istog/>
Tel: 038/ 200 438 14

NJOFTIM

Në bazë të neni 68, paragrafi 3 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) dhe Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës së Istogut, Ilir Ferati, në koordinim me zyrtarët dhe drejtorët e drejtorive komunale dhe në bashkëpunim me Zyrën për Informim Publik dhe Grupin Punues për Hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore KAB 2026-2028, organizojnë:

DËGJIMET BUXHETORE

për

KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE(KAB) 2026 - 2028

Të nderuar qytetarë të Komunës së Istogut, ju ftojmë që të merrni pjesë në **Dëgjimet Publike** për: **DRAFT - KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE (KAB) 2026 - 2028**.

Dëgjimet Publike do të mbahen me datat: **10, 11, 12, 13 Qershor 2025** sipas kalendarit të mëposhtëm.

Këto Dëgjime Publike, organizohen nga Kryetari i Komunës së Istogut në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Informim Publik.

Me qëllim që qytetarët të njihen rreth këtij dokumenti, Komuna e Istogut, konkretisht Zyra për Informim ka publikuar njoftimin dhe draft - Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026 - 2028. në ueb faqen zyrtare të Komunës së Istogut, <https://istog.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/> në rubrikën Dëgjimet Buxhetore.

Këto diskutime publike janë të hapura për të gjithë qytetarët e Istogut, duke përfshirë shoqërinë civile, profesionistët dhe ekspertët e fushave relevante, andaj ftoheni të gjithë pa dallim të merrni pjesë në Dëgjim Publik.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istog
Municipality of Istog

Kalendari i Dëgjimeve Buxhetore me qytetarë për KAB 2026 - 2028

Nr.	Bashkësia Lokale	Vendi i takimit	Data	Ora
1.	RAKOSH (Uçë, Kërrninat, Syrganë, Cerkolez, Zhakovë, Shushicë e Epërme dhe e Ulët)	Shfmu " Ndre Mjeda" Rakosh	E Martë 10.06.2025	 19:00
2.	SARADRAN (Trubuhoc, Prekallë, Dobrushë)	Shfmu "IsmailQemaili" Saradran	E Mërkurë 11.06.2025	 18:00
3.	VRELLË (Kaliqan, Prigodë, Studenicë)	Shfmu " HysniZajmi" Vrellë	E Mërkurë 11.06.2025	 19:00
4.	GURRAKOC (Kovragë, Tomoc, Veriq, Zallq, Zabllaq, Kosh, Drejë)	Shfmu " MartinCamaj" Gurrakoc	E Enjte 12.06.2025	 18:00
5.	BANJË (Carallukë, Kashicë, Lubovë, Orroberdë, Dubovë e Vogël)	Shfmu "Trepça" Banjë	E Enjte 12.06.2025	 19:00
6.	ISTOG (Istog i Poshtëm, Dubravë, Synajë, Mojstir, Muzhevinë, Lluga-Llukafç, Cerrcë, Lubozhdë)	Parku i Qytetit ISTOG	E Premte 13.06.2025	 19:00

Kryetari Komunes

z. Ilir FERATI

